

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE

AKTIVITETI I NXJERRJES SË MINERALIT TË KROMIT NË OBJEKTIN “FUSH-KALT”, PAISUR ME LEJE MINERARE NR 541, DATE 17.02.2000, NJËSIA ADMINISTRATIVE MARTANESH, BASHKIA BULQIZË, QARKU DIBËR

Subjekti “TADRI” shpk, është paisur me leje minerare Nr 541, date, 17.2.2000, Objekti “Fushë Kalthi”, Njësia Administrative Martanesh, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, për nxjerrjen e mineralit të kromit në këtë objekt. Krahas lejes minerare subjekti është paisur dhe me leje mjedisore për këtë aktivitet.

Që nga data e marjes së lejes e në vazhdim subjekti ka ushtruar aktivitetin e nxjerrjes së mineralit të kromit me minierës sipërfaqore karrierë.

Përshkrim i hollësishëm i projektit

Vendndodhja e Objektivit

Vend ndodhja. Objekti ndodhet në teritorin e Njësia Administrative Martanesh, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër. Zona minerare kufizohet nga sipërfaqja e kufizuar nga koordinatat e përcaktuara më poshtë:

Tabela e koordinatave

Nr. Pikës	X	Y
1	4489450	4537000
2	4489450	4537327.5
3	4489590	4537327.5
4	4489600	4537100
S=0.019212 km ²		

Ndertimi Gjeologjik i Rajonit

Objekti i kerkuar bën pjesë në masivin ultrabazik të Bulqizes, Ky ka një sipërfaqe prej rreth 350 km², ben pjese ne kompleksin ofiolitik te Albanideve.

Ne rajon ndeshen kryesisht formimet magmatike plutogjene dhe formimet sedimentare, qe kontaktojne me pervijimin e masivit. Ështe arritur ne perfundimin, se prerja e shkembinjve ultrabazike te rajonit nga poshte-lart nga analizat komplekse petrografike, nga te dhenat analitike, vrojtimet fushore, si dhe punimet e kerkim-shfrytezimit, eshte:

Harcburgite dhe Harcburgite-Dunite te fresketa;

Harcburgite-Dunite te serpentinizuara;

Harcburgite-Dunite shume te serpentinizuara;

Dunite-Harcburgite te serpentinizuara;

Dunite te serpentinizuara;

Piroksenite.

Harcburgitet, jane masat shkembore me te perhapura, ku bëjnë pjesë: olivina, pirokseni rombik, kromiti aksesor, serpentina dhe rralle takohen minerale dytesore, si talku, kloriti, etj.

Ato paraqiten kompakte, me ngjyre jeshile te erret dhe permbajtje te kokrrizave te piroksenit, qe perbejne 10÷60% te volumit te shkembit. Ne keto lloj shkembinjsh verehen teksturat e rrjedhjes, te perfaqesuara nga orientimet zinxhirore te kromshpinelidit deri ne shlire kromi dhe nga plano-paralelizmi i kristaleve te piroksenit, ku mbizoterojne elementet e shtruarjes: azimut shtrirje 310÷340°, renie jugperendimore e kend renie 45÷80°, ne perputhje me strukturat e pergjitheshme te masivit.

Dunitet, vijne pas harcburgiteve, trupa ne forma izometrike dhe te çrregullta, te medhenj, damare, breza, thjerza (linza) dhe shlire.

Trupat dunitike kane permasa me te medha, me forma te zgjatura deri ne izometrike. Me keto dunite lidhen vendburime dhe dalje kromi me forma te çrregullta, pikezime te rralla e mesatare.

Piroksenitet, kryesisht, ne pjesen jugore dhe jugperendimore te masivit. Sipas perberjes sasiore te mineraleve shkembformuese, veçojme piroksenin monoklin, me pak plagjeokllazin dhe olivinen.

Serpentinitet, jane te perhapura ne rajon. Proçesit te serpentinizimit i jane nenshtruar kryesisht horizontet me te siperme te profilit magmatik.

Ndertimi Gjeologjik i Objektivit

Objekti i i kromit “FUSH KALT” ndodhet ne zonen qendrore te masivit ultrabazik te Bulqizes. Mineralizimi i kromit, i vertetuar nga punimet fushore, ben pjese ne horizontin e siperme te mineralizuar te vendburimit Bater dhe vendoset ndermjet shkembinjve dunitike. Dalje te tilla linzore kane permasa te kufizuara ne shtrirje dhe renie dhe nuk kane asnje lidhje me krahet e mineralizuar te trupit kryesor kromitik te vendburimit.

Dunitet jane shkembinjte kryesore qe mbulojne objektin. Nga te dhenat e shpimeve te kryera nga siperfaqja me objekt kerkim-zbulimin e kraheve perendimore te vendburimit Bater, dunitet jane vertetuar deri 150÷170 ml trashesi. Ne to (dunite), olivina perben 65÷70%, serpentina 20÷30%, kromshpinelidi aksesor 0.5÷3%, etj.

Dunitet dhe harcburgitet karakterizohen nga parametra petrokimike te rritur, çka flet per faktin, qe keta lloje shkembore konsiderohen krommbajtes. Ne kete aspekt, nuk perjashtohet mundesia, qe gjate punes ne objekt, te takohen dhe linza te tjera.

Te dhena te shkurtra per llojin e mineralit

Minerali i kromit, qe do te prodhohet, do te jete i tipit magnokromit, me formule kimike Cr_2O_3 . Prodhimi do te destinohet per eksport, mbasi eshte i pershtatshem per prodhim ferrokromi karbonik, me permbajtje te larte karboni. Prodhimi do te jete i grupit 30÷34% Cr_2O_3 .

Nga analizat kimike te mostrave, rezulton se perberesit kryesore te tij, jane:

$\text{Cr}_2\text{O}_3=30-34\%$;

$\text{SiO}_2=18\%$;

$\text{FeO}=10\%$;

$\text{Al}_2\text{O}_3=7\%$;

$\text{MgO}=27\%$;

$\text{TiO}_2=0.16\%$;

$\text{CaO}=0.15\%$;

$\text{MnO}=0.12\%$;

$\text{NiO}=0.2\%$;

$\text{P}_2\text{O}_5=0.08\%$;

$\text{V}_2\text{O}_5=0.06\%$.

Humbjet ne kalcinim = 3.3%

Raporti krom/hekur = 2.6/1

Kushtet Hidrografike dhe Hidrogeologjike

Lidhur me këto kushte në projektin e shfrytëzimit tregohet se objekti “FUSH KALT”, ndodhet ne nje zone te qete, pa perrenj, prurjet e te cileve mund te pengojne punen. Disa prroska te vogla, te cilat mund te sjellin sasira te vogla uji ne periudhen me rreshje, duhet te mbahen nen vrojtim per te shmangur çdo te papritur. Ne objekt, ne kete faze, do te perdoret metoda e shfrytezimit me siperfaqe ne nje terren te favorshem, ku nuk behet fjale per kushte hidrogeologjike te veshtira, qe te pengojne gjate shfrytezimit.

Kushtet Tekniko-Minerare

Shkembijnje dunitike mbulojnë objektin. Linza e kromit ndodhet brenda ketyre shkembinjve. Shkembijnje u jane neneshtuar proceseve te alterimit ne siperfaqe.

Per kete aresye, megjithese ne thellesi horizonti Dunit-Harcburgit paraqitet kompakt, me qendrueshmeri mbi mesatare, Shkëmbijnjtë ne siperfaqe janë më të thermueshem dhe me çarshmeri te larte. Prandaj kërkohet nga ana e drejtuesit teknik te punimeve, te respektohen elementet e shkalleve, kendet e pjerresise se skarpatave te tyre sipas projektit dhe te behet krehja e vazhdueshme mbas çdo plasje.

Cilesia e mineralit nuk pritet te kete ndryshime me futjen ne thellesi te shfaqjes se mineralizuar. Qendrueshmeria e mineralit dhe shkembinjve rrethues, duket e mirë, por gjithmone, elementet e

shkalles, sidomos lartesia dhe kendi i pjerresise, do te jene orientues. Ato mbesheten ne karriera me kushte te ngjashme, por mbeten te eksperimentohen per situatat konkrete qe do te paraqiten dhe te korrigjohen hap pas hapi, ne dobi te rritjes se shkalles se sigurise ne pune.

Tektonika

Masivi ultrabazik i Bulqizes ka gjurme te tektonikes shkeputese, qe komplikojne shume strukturen e tij.

Zonat tektonike kane gjatesi deri disa qindra metra e trashesi nga disa cm ne disa dhjetra metra. Efektet negative te tektonikes shkeputese te pasmineralizimit, karakteristike per te gjitha vendburimet e kromit ne masivin e Bulqizes, nuk do te kene ndikim ne objekt, per disa aresye:

Rezervat gjeologjike dhe të nxjerrshme.

Linza e kromit, e dokumentuar dhe hedhur ne harten topografike ka gjatesi ne shtrirje rreth 35 ml. Ndërsa trashesia mesatare eshte 2 m. Ne te dy drejtimet e shtrirjes, ate juglindor dhe veriperendimor, verehet mbyllje gjenetike e linzes. Azimuti i shtrirjes eshte $320\div 330^\circ$. Gjate ndjekjes ne shtrirje te saj, nuk konstatohet prania e tektonikes shkeputese.

Mbi bazen e elementeve te fiksuar ne siperfaqe, si gjatesi 35 ml, trashesi 2 m, gjatesi ne renie 15 ml dhe peshe volumore 2.5 ton/m^3 , sasia e rezervave gjeologjike, në projekt janë gjykuar te kategorise B, llogariten 3370 ton, me cilesi ne bllok, nga analizat e kryera nga tri prova te marra ne daljen siperfaqesore ne pozicione te ndryshme gjate shtrirjes, 33.2% Cr_2O_3 . Ndërsa rezerva të nxjerrshme nga llogaritjet rezulton se janë 2370 ton.

Nisur nga lloji i shkembinjve qe ndertojne objektin dhe pozicionin hipsometrik te ketyre llojeve shkembore, qe i takojne horizontit te siperm Dunit-Harcburgit, nuk behet fjale per ndonje zone perspektive ne takimin e linzave te tjera ne objekt dhe nje shtim te mundeshem te rezervave. Gjithçka, do ta vertetojne punimet qe do te kryhen per shfrytezimin e objektit.

Zgjedhja e menyres se shfrytezimit.

Për shfrytëzimin e këtij minerali, kur trupi ose linza e kromit ka dalje ne siperfaqe, gjatesia ne renie e saj eshte e kufizuar, koeficienti i zbulimit eshte i pranushem dhe relievi favorizon shfrytezimin me qiell te hapur (karriere) shfrytezim i cili ka filluar pasi u moren lejet perkatese dhe do te vazhdoje dhe ne te ardhmen.

Kapacitetit nxjeres eshte 300 ton ne vit me cilesi 35% Cr_2O_3 .

Koeficienti i zbulimit

Nga llogaritjet në project rezulton se koeficienti i zbulimit është 7.8 m^3 shkemb për 1 ton mineral kromi.

Per shfrytezimin linzes, do te hapen kater shkalle, duke filluar ne +1495 dhe duke zbritur

Kapaciteti prodhues

Ky vend burim përbëhet nga një linzë e cila i ka permasat të kufizuara ne shtrirje dhe renie. Për rrjedhojë dhe permasat e karrieres do jene te vogla, nuk mund te mendohet per prodhim te madh dhe volum te madh zbulimi. Ne zbulim dhe shfrytezim, te cilet do te ecin paralelisht, do te perdoret nje mjet ngarkimi dhe nje mjet transporti.

Kapaciteti i kufizuar i prodhimit bën që të perdoren bira te shkurtra minash ne rrezim, si dhe per te siguruar nje shfrytezim selektiv me sa me pak varferim e humbje. Vetem keshtu, mund te garantohet qe minerali, i cili ka permbajtje ne bllok 33.2% Cr_2O_3 , te prodhohet per t'u eksportuar ne grupin me 30÷34% Cr_2O_3 .

- Pozicioni i daljes ne siperfaqe te mineralizimit te kromit;
- Kuotat dhe gjatesia ne shtrirje e daljes;
- Konturet e siperfaqes se kerkuar per leje shfrytezimi dhe pozicioni i rruges automobilistike Luçane-Bater;
- Konturet e subjekteve te tjera te licensuara ne lindje dhe perendim te objektit, si dhe infrastruktura rrugore egzistuese per te lehtesuar hyrjen e makinerive ne objekt.

Sistemi i shfrytezimi.

Sistemi i shfrytezimit qe eshte zbatuar dhe do te vazhdoje te zbatohet eshte me karriere me transport te thejshte te sterileve brenda siperfaqes se karrieres.

Elementet e sistemit të shfrytëzimit dhe treguesit e pritshem

Në projekt janë përcaktuar si më poshtë:

- Lartesia vertikale e shkalles: 10 m
- Gjeresia e sheshit te punes: jo me e vogel se 10 m
- Kendi i skarpates se shkalles: 65°
- Gjeresia e shesheve te sigurise midis shkalleve: 3 m
- Kapaciteti ditor ne zbulim: 46÷25 m³/dite
- Kapaciteti ditor ne prodhim: 6÷8 ton/dite
- Ngarkimi dhe transporti: te mekanizuar
- Menyra e rrezimit: me lende plasese
- Humbjet gjate shfrytezimit: 4%
- Varferimi gjate shfrytezimit: 4%

Pasaporta e shpim-plasjes, llogaritjet e lendes eksplozive dhe materialeve plasese, qe do te perdoren

Në projekt tregohet se kushtet gjeologjike dhe tekniko-minerare te shkembinjve dhe mineralit, qe ndertojne objektin, bejne te domosdoshem perdorimin e lendes plasese ne zbulim dhe rrezimin e mineralit.

Shfrytezimi selektiv i mineralit, me varferim minimal dhe humbje sa me te pakta, kërkon përdorimin e bira minash, te hapura me cekice shpues te lehte, 24-25 kg, te vendosur mbi mbajtese. Diametri i birave është 42 mm dhe thellesi 2 m. Kjo mënyrë e shpim plasjes do te ndajë shkallën ne 5 nenshkalte me lartësi 2m secila.

Pasaporta e shpim-plasjes ka këto parametra:

- Gjatesia e çdo bire: 2.2 ml
- Diametri i bires: $\phi=42$ mm
- Vendosja e birave: ne rrjesht
- Numuri i rrjeshtave, qe do te shperthehen njeheresh: 1 (nje)
- Numuri i birave qe do te shperthehen njeheresh: $7\div 4$ cope
- Distanca e birave nga buza e skarpates: 1.2 m
- Vija e rezistences me te vogel: $\ddot{e}=2.0$ m
- Ngarkesa e lendes plasese ne bire: 1.8 kg
- Lloji i lendes plasese ne perdorim: amonit
- Volumi i shkembit, te rrezuar nga nje bire: 6 m^3
- Sasia maksimale e lendes plasese ne shperthim: 12.6 kg
- Konsumi specifik i lendes plasese ne zbulim: 0.3 kg/m^3 shkemb
- Konsumi i kapsollave elektrike ne zbulim: 0.13 cope/m^3
- Konsumi i telit te linjes ne zbulim: 0.23 ml/m^3

Makineritë dhe paisjet e shpim ngarkimit

Objekti eshte i vogel. Volumet ditore te punes jane minimale. Ne keto kushte, subjekti përdor nje ngarkues, me kapacitet kove $1\div 1.5\text{ m}^3$, nje mjet transporti $8\div 10$ tonesh, nje motokompresor qe prodhon $3.5-4\text{ m}^3/\text{min}$ ajer te ngjeshur, nje cekic shpues dhe disa baromina.

Përcaktimi i zonës së rrezikshme nga punet me lende plasese

Përdorimi i lendës plasese per rrezimin e shkembit dhe mineralit është i domosdoshëm për shkak të fortësisë së tyre. Problemi kryesor eshte mbrojtja nga flakerimi i copave te materialit (shkemb ose mineral), gjate shperthimit. Ne Rregulloren e Teknikes se Sigurimit per punet me Lende Plasese ne Miniera dhe Nafte, botim i vitit 2002, neni 238 i saj, ne rastin e shperthimit te ngarkesave me bira minash, kufijte e zones se parrezikshme nga flakerimi nuk duhet te jene me te vogla se 300 ml nga vendi i shperthimit.

Në projekt është përcaktuar kufiri i zonës së parrezikshme nga flakërimi i coprave. Nga llogaritjet ky kufi është përcaktuar të jetë 326 ml.

Mbi keto rezultate, drejtuesi teknik, qe para shperthimit, vendos roje dhe nuk lejon qe te kalojne njerez ne nje zone me rreze 330 ml nga vendi i shperthimit..

Organizimi i punes dhe fuqia punetore

Organizimi i punes eshte me nje turn ne 24 ore, vetem turni i pare, 6 dite pune ne jave ose 26 dite pune ne muaj dhe 7 muaj ne vit.

Per vete kushtet klimaterike te veshtira te zones, dimrin e ftohte e te zgjatur, koha me e favoreshme do te jete 15 Prill deri 15 Nentor, te çdo viti.

Mbeshtetur ne volumin e punes dhe siperfaqen e kufizuar te karrieres, do te punesohen 4 punonjes: drejtues teknik 1, minator + zjarrmetar 2 dhe manovrator 1.

Vend banimi me i afert eshte, Qyteza e Krastes, me rreth 3000 banore, e cila ndodhet 12 km larg objektit ne rruge automobilistike, sipas itinerarit Kraste-Luçane-Bater është qendra me e afert e banuar.

Gjeografia e Zones

Zona, ne te cilen perfshihet objekti "FUSH KALT", administrativisht bën pjesë në komuna Martanesh, rrethi Bulqize, Qarku i Dibres. Qendra e komunës është Krasta. Objekti eshte i vendosur ne shpatin veriperendimor te luginës se vendburimit Bater, ne nje terren te pjerret dhe te zhveshur. Me përjashtim të Krastës e cila është 12 km në rrugë automobilistike larg objektit qëndrat e tjera të banuara fshatrat e zonës janë shumë më larg se Krasta.

Shpati veriperëndimor i luginës së vendburimit Batër është një shpat i ezauruar nga punimet minerare dhe nga galeritë e hapura. Galeritë në këtë shpat dhe stoqet e sterileve janë të trashëguara nga aktiviteti minera i së kaluarës kur këtu funksiononte Miniera e Batrës si formë e ndërmarjeve socialiste.

E gjithë kjo zonë apo shpati veriperëndimor është i çveshur nga bimësia dhe i pa populluar.

Maja me e larte e zones eshte Maja e Dhoksit +2019 m mbi nivelin e detit dhe ndodhet ne veri-verilindje te objektit. Siperfaqja, e kerkuar per leje shfrytezimi, vendoset midis kuotave +1460 m ne jug dhe +1725 m ne veri.

Popullsia

Popullsia e zonës në numur po vjen gjithnjë e në ulje për shkak të emigracionit dhe lëvizjeve në drejtim të qyteteve të mëdha.

Qendra me e afert e banuar eshte qyteza e Krastes dhe fshatrat perreth saj. Nga ketu, do te sigurohet dhe fuqia punetore, qe do te nevojitet gjate ushtrimit te aktivitetit minerar ne objekt, e cila egziston si rezultat i aktivitetit minera të ushtruar në këtë zonë prej vitesh.

Klima

Klima e zonës eshte kontinentale, me dimer te gjate, te lagesht (kryesisht rreshje debore), te ftohte, me ngrica dhe vere te shkurter e te nxehte.

Periudha e dimrit, e cila fillon rreth 15 Nentorit, shoqerohet me rreshje te medha debore, here-here mbi 1 m trashesi, me erera te ftohta qe vine nga veriu dhe verilindja, me ngrica dhe orteqe debore. Kjo periudhe zgjat deri me 15 Prill. Temperaturat me te ulta te regjistruara ne kete periudhe, kane shkuar deri -25° C.

Mbeshtetur ne sa thame, ne projektin e hartuar nuk eshte parashikuar te punohet nga 15 Nentori deri me 15 Prill, per nje periudhe 5-mujore. Kohe pune efektive ne vit do te jete vetem periudha 7-mujore, nga 15 Prilli deri me 15 Nentor.

Infrastruktura e zones

Në përgjithësi infrastruktura e zones eshte e varfer Në këtë zonë rruga automobilistike është e ndërtuar sepse ka shërbyer për evadimin e mineralit të kromit gjatë jetës së minierës së Batrës dhe shërben për subjekte private

Kjo rrugë ka nevojë për riparime mbasi ka vite që nuk është vënë dorë. Ajo kalon ne skajin jugor te sipërfaqes se kerkuar dhe qe shfrytezohet nga te gjithë subjektet e licensuara ne kete zone. Mungojne linjat elektrike, telefonike dhe ndertime te tjera civile.

Ekonomia e Zones dhe Aktivitetet kryesore te saj

Në përgjithësi zonat verilindore, dhe zona e Martaneshit, janë me nje nivel te ulet ekonomik. Mungesa e tokës, klima e ftohte, sipërfaqja e paket dhe produktiviteti i ulet i tokave bujqesore, largesia nga qendrat urbane, ka shkaktuar nje zhvendosje masive te popullsisë drejt qyteteve të mëdha.

Sot në këtë zonë, aktiviteti minerar eshte me fitimpruresi per banoret e mbetur atje. Nje pjese e mire e tyre, duke qene punonjes te ish minierave Bater, Kraste, Theken, etj., jane aktivizuar si te punesuar ne mbi 30 subjekte te licensuara ne kete zone

Flora.

Sipërfaqja e kërkuar për shfrytëzim është tërësisht e çveshur nga çdo lloj bimësije. Jo vetëm kjo sipërfaqe por e gjithë zona siç quhet ndryshe shpati veriperëndimor i luginës së vendburimit Batër është pothuajse tërësisht i çveshur nga bimësia. Në këtë shpat tek tuk takon shkurre dhe dëllinjën si dhe barishte me gjatësi deri disa cm të shpërndarë vende vende.

Pjesa tjetër përballë këtij shpati, ajo juglindore është një zonë në të cilën nuk është ushtruar aktiviteti i nxjerrjes së mineralit të kromit sepse në këtë zonë nuk ka mineral, është e gjelbëruar dhe aty rriten pisha të lartësive deri në mbi 10m. Kjo zonë është përballë objektit të kërkuar në një distancë të largët prej tij.

Fauna.

Në një zonë të shkretë e të varfër nga flora detyrimisht që dhe flora nuk është e zhvilluar. Flora në sipërfaqen e kërkuar mungon fare, po kështu dhe në shpatin veripërendimor.

Pamvarsisht nga kjo zona e Batrës, këtu bëhet fjalë për pjesën e zonës jashtë aktivitetit minerar deri në majën e Dhoksit e më tutje në Kaptinë të Martaneshit është shumë e pasur me elementët e florës dhe faunës.

Pishat e larta dhe skurret e dëllinjat si dhe lloje të tjera vegjetacioni përbëjnë florën duke u shoqëruar nga një faunë e egër mjaft e pasur me elementë si në zogj të ndryshëm, zvarranikë, bile aty takohen dhe dhelpra, ujku e jo rallë ariu.

Përshkrim i hollësishëm të të gjitha instalimeve, që bëjnë pjesë në projekt ose që përdoren gjatë zbatimit të tij.

Në projektin e shfrytëzimit, në kapitullin e konditave tekniko minerare dhe vetive fiziko mekanike të mineralit, është përcaktuar së shfrytëzimi i mineralit të kromit për vetë karakteristikar që ka do të bëhet me anë e punimeve të shpim plasjes. Për të realizuar këtë do të përdoret çekiçi shpues i cili punon me ajër të komprimuar. Pra do të vendoset një motokompresor $10m^3$ dhe 2 çekiçë shpues dhe në raste të vecanta një sondë 100mm.

Lidhja nga motokompresori me mjetet e shpimit do të bëhet me tub gome nëpër të cilin do të kalojë ajri i komprimuar. Për punët e ngarkimit është parashikuar në projekt që subjekti të përdorë një fadromë ose mjet me krahë me kapacitet kove $0.5m^3$. Eskavatori do të shërbejë për ngarkimin e materjalit. Minerali i nxjerrë do të ngarkohet në mjetet vetshkarkuese të transportit me kapacitet nga 10ton. Siç shikohet, zbatimi i projektit të shfrytëzimit të kromit nuk do të kërkojë vendosjen e paisjeve apo makinerive, të cilat do të kërkonin instalime. Zbatimi i këtij projekti i përjashton kategorikisht instalimet e tjera.

Plani i ndërtimit dhe afatet e zbatimit të tij

Plani i ndërtimit të karrierës, pra plani, për hapjen, përgatitjen, shfrytëzimin e kromit dhe kryerjen e proceseve të tjera të shërbimit të makinerive dhe pajisjeve parashikohen të ndërtohen objektet e përmendura më poshtë:

Rezervat në objekt, tregojnë për një objekt të vogël me sasi të kufizuara rezervash 2370 ton mineral. Infrastruktura për këtë objekt është e kryer sepse në pjesën jugore të tij, kalon rruga automobilistike.

Këtu do të bëhet dhe grumbullimi i mineralit të nxjerrë nga karriera.

Infrastruktura egzistuese bën që të mos të ketë nevojë për hapje rrugeshe të reja. Numri i vogël i të punësuarve vetëm 4, natyra e vetë kësaj kariere eliminon nevojën e objekteve sipërfaqesore

industriale, si impiant seleksionimi, bunkera, etj., objekte sipërfaqesore sociale për trajtimin e punonjesve, etj., pasi punonjesit do të vijnë nga vendbanimet e tyre me automjetet e do të çohen me automjetet në fund të turnit.

Për të kompensuar mungesën e energjisë elektrike sepse në afersi të objektit, nuk kalon linja elektrike prodhimi i ajrit të ngjeshur do të zgjidhet duke përdorur motokompresor, ndërsa për nderlidhje, do të përdoren telefona mobil. Pra nuk do të investohet për linjë elektrike dhe telefonie.

Megjithatë për të hapur karrierën dhe për të nxjerrë mineralin e kromit subjekti "Tadri" sh.p.k. ka bërë investimet e mëposhtme deri në 16.740 USD.

Këto investime do të bëhen për paisje e makineri sipas një plani të detajuar si më poshtë:

Nr.	Emertimi i makinerive	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi USD	Vlefëta USD
1.	Motokompresor	cope	1	5.500	5.500
2.	Mjet ngarkimi	cope	1	10.500	10.500
3.	Tuba ajri	ton	0.3	800	240
4.	Çekice shpues	cope	2	250	500
	Gjithesëj				16.740

Veprave inxhinjerie, që ndërtohen ose zgjerohen dhe të veprave të domosdoshme për zbatimin e projektit.

Hapja dhe shfrytëzimi i mineralit të kromit në objektin "Fush Kalt" Martanesh, do të bëhet nëpërmjet punëve në karrierë. Hapja dhe ndërtimi i kësaj karriere në vetvete është veprë inxhinjerie e cila do të realizohet duke zbatuar me përpikmëri dhe rigorozitet projektet e hapjes dhe shfrytëzimit..

Gjate hapjes dhe shfrytëzimit në karrierë do të zhvillohen elementë, si transhetë, shkallët dhe frontet e shfrytëzimit deri në formën përfundimtare që do të marrë karriera mbas 10 vitesh pune, formë amfitetri.

Karriera do të ketë këto elementë në gjendje përfundimtare

Nisur nga pozicioni gjeografik i karrieres, relievi dhe parametrat gjeometrike të shkalleve, karriera do të ketë formën e një 3/4 stadiumi me zgjatje jugë lindje dhe veri perëndim, me parametrat e mëposhtme

- Thellessia maksimale: 40 m
- Thellessia mesatare: 20 m

- Numuri i shkalleve: 4
- Gjeresia ne plan, ne pjesen e sipërme: 50 m
- Gjeresia e sheshit te poshtem: 10 m
- Gjatesia ne pjesen e sipërme: 70 m
- Gjatesia ne sheshin e poshtem: 42 m
- Kendi i shuarjes se shkalleve: 57°

Ndikimet tek njerëzit, ndërtesat dhe objekteve të ndërtuara nga njeriu

Teknologjia e hapjes dhe shfrytëzimit të mineralit të kromit, vendndodhja larg qëndrave të banuara dhe punësimi i vetëm 4 punonjësve tregojnë se ky projekt nuk ka ndikim në njerëz, ndërtesat dhe objektet e ndërtuara nga njeriu.

Ndikimet e dukshme të projektit të zhvillimit në zonat rrethuese dhe pejsazh

Nga zbatimi i projektit të shfrytëzimit të mineralit të kromit pejsazhi në përgjithësi nuk do të ndryshojë. Zona që kërkohet për shfrytëzim është një zonë me sipërfaqe shumë të vogël, 0.075 km². Kjo sipërfaqe nuk përbën problem për zonën në tërësi si dhe për pejsazhin. Ky projekt nukdo të bëjë transformime rrënjësore në pejsazh. Ndyshim do të pësojë vetëm sipërfaqja që do të shfrytëzohet e cila në fund të jetës së minierës do të ketë formën e një miniafiteatri.

Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga projekti i zhvillimit gjate fazes normale te operimit

Në projekt tregohet se nga aktiviteti i nxjerrjes së mineralit të kromit nuk do të kete emetime, për kujtesë të vetmet emetime do të vijnë nga eskavatori dhe nga mjetet e transportit. Të dy këto lloj mjetesh emetojnë sasira gazesh të cilat janë rezultat i punës së motorave me djegje të brëndëshme, brënda normave të lejuara. Këto mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontroleve teknike vecanërisht për emetimet e gazta.

Gjithashtu nga përdorimi i amonit malor, emetohen gazra të cilat brënda një kohe shumë të shkurtër gati 5 minuta hollohen ne ajrin e atmosferes dhe nuk do te kene asnje ndikim negativ ne mjedisin perreth objektit.

Nivelet dhe ndikimet e zhurmave.

Kariera është e vendosur shumë larg qëndrave të banuara, më e afëtra është Kratsa disa km larg në vijë ajrore. Zhurmat që shoqërojnë punën në karrierë janë zhurma të proceseve teknologjike si shpimi, shpërthimi i minave dhe ngarkim transporti. Këto zhurma në një zonë të thellë malore nuk përbëjnë problem.

Nga llogaritjet rezulton se burimi kumuluar i zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte 180 dB.

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal.

Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe paisje tregon tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200-2000Hz, e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut .

Pluhurat gjate procesit te punes

Në ato raste kur mund të ketë çfaqje pluhuri gjatë bërjes së birave, për eliminimn e tij në projekt është parashikuar të bëhet sperkatje me uje.

Ndikimi ne mjedis i produkteve te lenedeve plasese

Perdorimi i lendes plasese do te jape efekte te zhurmave, vibrimeve, vales goditese dhe flakerim te copave. Per eliminimin e te gjitha pasojave qe mund te vijne nga faktoret mesiperem ne projekin e shfrytëzimit jane parashikar masat te posaçme qe trajtohen ne percaktimin e kufijve te zonave te rrezikshme

Ndikim ne mjedis i gazeve te mjeteve motorike

Gjate fazes se zbatimit te projektit nuk do te kete emetime te gazrave, lengjeve, mbetje toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth duke perfshire te gjitha llojet e bimeve dhe gjallesave te ndryshme.

Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta dhe depozitimi i materialve qe krijohe gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit

Gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit do te kete depozitim te sterile te shkriфта në stoqet e trashëguara të depozitimit të sterileve të minierës batër.

Një pjesë e sasisë së sterility ajo më fertilja do të rivendoset në sheshet e shkallëve të karrierës në koheë që do të bëhet rehabilitimi i mjedisit.

Ato perfaqesohen nga deluvione te shkriфта, qe nuk permbajne elemente ndotes per ambientin. Keto depozitime jane fertile dhe do te sherbejne me se miri per rigjenerimin e karrieres

Ndikimet e projektit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportin.

Gjatë zbatimit të projektit nuk do të ketë ndryshim të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Do të shfrytëzohet rrjeti rrugor egzistues.

Ndikimet e projektit te zhvillimit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore, p.sh si pasoje e ndotesve, shqetesimeve vizuale, vibracionit

Projekti percakton se aktiviteti i shfrytezimit te kromit do te zbatohet ne nje zone ne sipërfaqen e së ciles dhe në nëntokën e saj nuk ka ndertime trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore. Projekti zbatohet në një zonë mineralmbajtëse.

Ndikimet ne flouren, faunen dhe gjeologjine

Sipërfaqja e kërkuar për nxjerrë të kromit është sipërfaqe pothuajse e cveshur. Në këtë sipërfaqe nuk ka bimësi, në të nuk takohen elemente te flores apo të faunës.

Ndërsa në zonën rreth saj në distanca të konsiderueshme në largësi rritet e zhvillohet flora e zonës ku bëjnë pjesë kryesisht pisha, dëllinja, etj. Ndërsa në zonat e banuara në largësi mbi disa km me objektin rriten lule dhe barishte si dhe kultivohen bime te ndryshme bujqesore dhe foragjere.

Në zonë rreth sipërfaqes së kërkuar për shfrytëzim, gjithnjë në pjesën e mbuluar me vegjetacion, takohen thëllëza, lepuj të egër dhe shumë zogj të tjerë përfshi harabelat e mullenjat.

Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike.

Vend burimi në të cilin kërkohet të ngrihet kariera nuk përbën objekt në të cilin të jenë ndërthurur tipare gjeologjike të vecanta. Kjo përbën një pjesë të zakonshme të formacioneve ultrabazikë të zonës, përrjedhojë shfrytëzimi i kromit nuk dëmtohen tiparet gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike.

Ndikimet ne toke

Në projektin teknik të shfrytëzimit të këtij objekti janë projektuar të gjitha punimet e hapjes e të shfrytëzimit. Ne fund të shfrytëzimit pra mba një periudhe kohore prej 3 vitesh, do të kemi një pamje në formën e amfiteratrit vetëm të sipërfaqes së kërkuar për shfrytëzim.

Kariera në vetvete, elementët e saj, krijimi i shkallëve të karrierës nuk ndikojnë negativisht në topografisë e zonës për arsye se sipërfaqja e karrierës është e vogël si dhe përmasat e shkallëve janë të papërfillshme në lidhje me zonën ku është vendosur kariera. Gjithashtu synohet që parametrat e karrierës dhe vecanërisht elementët e shkallëve mos të ndryshojnë por do të punohet për ti ruajtur e mirmbajtur ato. Në projekt është parashikuar që të investohet 100lekë/m³, për mbjelljen e fidaneve të pemëve karakteristike të zonës, këto pemë do të mbillen në sheshin e shkallëve ku ka mbaruar shfrytëzimi. Të gjitha sa më sipër cojnë njëkohësisht dhe në zbutjen e efekteve të erozionit lokal.

Zona ku do të ndërtohet kariera është një zonë me formacione ultrabazikësh shumë të fortë për pasojë influenca e erozionit është e papërfillshme në këtë sipërfaqe sepse.

Humbje e pjerese se tokes

Ne projekt, pjeresia skarpatave te shkalleve eshte parashikuar te jete 57°. Kjo pjerese eshte me e madhe se ajo natyrale e terenit te objektit. Mbas sistemimit perfundimtar dhe mbushjes do te tentohet qe ajo te ulet edhe 10° te tjera, per pasojë humbja e pjerese se tokes nga shfrytezimi nuk do e jete e konsiderueshme.

Ndikimet e emertimeve kimike dhe te depozitimeve ne token dhe rrethinat ku do te zhvillohet projekti i zhvillimit

Duke studjuar projektin e shfrytezimit të kromit, teknologjinë që do të përdoret, makineritë e paisjet vërejmë se nga zbatimi i këtij projekti nuk do të kemi emetime kimike apo depozitime në tokë në zonën e shfrytezimit dhe përreth saj. Aktiviteti është proces thjesht mekanik duke mos emetuar elementë kimikë.

Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe te burimeve:

Projekti përjashton në mënyrë kategorike ndikimin në cilësi dhe sasi të tokës bujqesore për vetë faktin se nuk zbatohet në tokë bujqesore dhe se ndodhet në distancë të konsiderueshme larg tyre.

Ky projekt në vetvete është projekt mineralar për shfrytëzimin e mineraleve të grupit të katërt përcaktuar simbas Ligjit Mineralar Shqiptar Në këtë kontekst projekti ndihmon në aktivitetin mineralar.

Përsa i përket burimeve minerare vërejmë se minerali i kromit mer vlerën e tij të vërtetë si minerale mbasi vihen në shfrytëzim, në rastin konkret në procesin e nxjerrjes.

Nuk vërejmë alternativë tjetër për tokën, konkretisht kjo sipërfaqe është e cveshur dhe bën pjesë në rezervat e kromeve të zonës.

Ky projekt nuk ndikon në tokat përreth jo vetëm se zhvillohet në distanca të largëta nga tokat por njëkohësisht nuk ka shkarkime të lëngëta, të ngurta të gazta që mund të ndikojnë indirekt në tokat rreth kësaj sipërfaqe.

Errozioni gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit mineralar.

Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtimi i tille i shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin, shembjen dhe vithisjen e shpateve te karrieres dhe siperfaqes se tokes rreth saj.

Ndikimet ne uje

Duke studjuar projektin konstatojmë se ky aktivitet do të zhvillohet larg objekteve ujore si liqene lumenj dete apo rezervuarë. Projekti do të zbatohet në një sipërfaqe ku nuk ka kanale apo vepra të tjera arti të cilat të lidhen me modelin drenazhues të zonës. Ky projekt nuk takon fare me modelin

drenazhues të zonës. Objekti uxor më i afërt është përroi i Batrës i cili nuk do të ndikohet nga aktivitetit.

Ndryshimet e karakteristikave të tjera hidrografike, si psh., niveli i ujrave tokësore, i rrugëve ujore, i rrjedhjes së ujrave nëntokësore.

Ky aktivitet mineral dhe nuk ka lidhje fare me karakteristika të tjera hidrografike, sepse sipërfaqja e kërkuar nuk përbën subjekt hidrografik, aty nuk ka ujë, nuk ka rrugë ujore, nuk ka burime uji, përrenj si dhe nuk janë vërtetuar ujra nëntokësore.

Trajtimi i ujrave

Teknologjia shfrytëzimit të objektit nuk parashikon përdorimin e ujit. Ujrat e reshjeve do të dekantohen në gropa brenda zonës së shfrytëzimit. Rrjedhja e me tejshme e tyre do të bëhet në përputhje me rrjedhjen natyrale të tyre me anë të një kanali në anë të rrugës së hapjes deri në kanal dhe rrugës së poshtme dhe me pas në perrua.

Ndikimet në hidrologjinë bregdetare dhe të estuarve.

Distanca shumë e largët nga bregdeti dhe lumenjtë bën që projekti i nxjerrjes së kromit mos të ketë ndikim në hidrologjinë bregdetare dhe estuarët e lumenjve.

Ndikimet e ndotësve, mbetjeve, etj., në cilësinë e ujit.

Nga projekti rezulton se aktiviteti në karrierën nuk shoqërohet me mbetje apo shkarkime të ndryshëm të cilët ndotin elementët mjedisor si uji, toka, ajri. Aktiviteti në karrierë është shumë i thjeshtë. Aty veprojnë mjete të kontrolluara si eskavatori dhe mjete të transportit, mjete të cilat shkarkojnë vetëm gaze brenda normave të lejuara.

Ndikimet në ajër dhe në klimë

Ky aktiviteti nuk shoqërohet me emetime kimike, për rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me përqëndrime dhe ndikim të tyre në mjedis.

Nxjerrja e mineralit të kromit në karrierën në objektin e quajtur Fushë e Kaltër nuk do të kryhet me përdorimin e lëndëve të veçanta, me emetimin e aromave sulfurose, me ndikime të ndryshme në klimë, nuk do të ketë ndikim në trafikut e transporteve, me ujin, energjinë dhe burimet e tjera, me zonat e banuara, etj.

Ky projekt nuk shoqërohet me ndikime sekondare apo me ndikime në projekte të tjera.

Plani i monitorimit

Plani i monitorimit është hartuar duke marrë parasysh aktiviteti i cili do të zbatohet në karrierën e mineralit të kromit objekti “Fush Kalt”, Batër. Për këtë arsye nevojitet monitorim i vazhdueshëm, veçanërisht gjatë shfrytëzimit dhe mbas tij. Ky monitorim do të shtrihet jo vetëm në sipërfaqen ku ushtrohet aktiviteti por dhe rreth saj.

Konkretisht plani i monitorimit do të konsistoje ne :

- Treguesit gjeomekanike te formacineve si qendrueshmeria ne shtypje e prerje
- Elementet e shrirjes dhe te renies se tyre
- Sistemin e çarjeve qe prekin zonen e shfrytezimit
- Sistemin e çarjeve qe prekin zonen e shfrytezimit
- Monitorimin e parametrave gjeometrike te shkalleve te shfrytezimit si: pjeresi, lartesia, kendi i skarpatës, pjeresia e sheshit te punes si dhe parmtrave gjeometrike te parshikuar ne projekt.
- Monitorimi i siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale e mbirjes dhe zhvillimit te tyre. Ne rastet kur verehet se ka demtime merren masa per zevendesime me fidane te rinj.
- Monitorimin e zones se mundeshme te shperndarjes se pluhurit gjate aktivitetit te shfrytezimit, në rast se do të kirijohet një situatë e tillë.
- Monitorimin e parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatase te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij
- Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shplarjeve, gryerjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre.
- Monitorimin e lëvizjes së produktit në mjetet e transportit.
- Monitorimi i sjelljes se bimesise ekzistuese ne zonen per rreth karrieres dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre
- Monitorimin e sjelljes së bimësisë ë mbjellë deri një vit pas mbjelljes së saj.

Subjekti ”Tadri” sh.p.k.mer persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit, gjithashtu ky subjekt do të mbajë lidhje të vazhdueshme me Agjensine Rajonale te Mjedisit Qarku Dibër prane se ciles do te informoje

periodikisht për mbarvajtjen e punës si gjatë shfrytëzimit ashtu dhe për monitorimin e parametërve të me mesem.

Përputhjen e projektit me planet e zhvillimit të territorit dhe me planet e zhvillimit ekonomik të zonës ku do të zbatohet projekti.

Vëndburimi i mineralit të kromit në objektin “Fush Kalt” është një vëndburim i cili mbas studimeve gjeologjike është i gatshëm për shfrytëzim. Në zbatim të Ligjit Minerar Shqiptar Nr 7796, date 17/02/1994 minerali i kromit është klasifikuar si mineral i grupit të parë. Studimet gjeologjike kanë përcaktuar mbi 3000 ton rezerva minerali kromi në këtë vëndburim. Nga këto 2370 ton janë të nxjerrshme. Në projektin minerar është planifikuar që kjo sasi rezervash mund të shfrytëzohet për një periudhë prej 3 vitesh. Subjekti “Tadri” sh.p.k. për realizimin e projektit do të punësojë 4 punonjës, duke mos llogaritur punonjësit të cilët do të transportojnë mineralin me mjetet e transportit.

Zona ku do të zbatohet projekti është një zonë me aktivitetet të theksuar minerar. Në këtë zonë, në fshatrat për rreth popullsia meret kryesisht me bujqësi e blektori, ndërsa aktivitetet industrialë në këtë zonë vecanërisht ato të nxjerrjes së mineralit të kromit kanë filluar të shtohen shumë.

Në planet e rregullimit të teritorit që ka komuna për këtë zonë përcaktohet vetëm shfrytëzimi i mineralit duke mos lënë mbas dore blektorinë. Kjo kushtëzohet nga resurset si dhe nga vetë përvoja e banorëve të zonës, të cilët vazhdimisht kanë punuar në industrinë minerare.

Pamvarsisht se në këtë objekt numuri i punonjësve do të jetë i vogël, përsëri ato do të punësohen në këtë objekt, gje e cila përputhet me planet e zhvillimit ekonomik të zonës, plane të cilat si çështje kryesore kanë punësimin e popullatës.

Zbatimi i këtij projekti është vazhdimësi i aktiviteteve të industrisë minerare në këtë zonë, industri e cila po zhvillohet e po fuqizohet në mbështetje të shfrytëzimit të kromit duke u gërshetuar më së miri me planet e rregullimit të teritorit dhe planet e zhvillimit ekonomik të zonës.

Masat rehabilituese, në rast ndotjeje dhe dëmtimi të mjedisit, si dhe koston e tyre.

Në projektin e shfrytëzimit përcakton saktë dhe qartë masat të cilat do të meren gjatë zbatimit të tij për të shfrytëzuar pa probleme për mjedisin dhe punonjësit. Konkretisht në projekt janë përcaktuar:

Sigurimi nga rreshqitjet dhe ruajtaje kendeve skarpatave te llogarituara

Duke pasur parasysh treguesit treguesit gjeomekanike te formacineve eshte llogaritur kende i skarpates duke perdorur metodat kompiuterike. Nga llogaritjet ne projekt del se kende i shuarjes se shkalleve eshte 57°

Kende i skarpates ne pjeset me perkulje konvekse te shkalleve (cepat e karrieres) eshte pranuar 4-6 grade me i vogel .

Per te siguruar nje qendrueshmeri normale te skarpatave dhe shesheve te punes parashikohet qe sheshet e punes te kene nje pjeresi prej 1-2% ne drejtim te transhese kryesore duke siguruar rrjedhen normale te ujrave dhe duke parandaluar ngopjen e formacionve argjilore nga uji.

Sigurimi teknik ne proceset e punes per hapjen shfrytezimin dhe administrimin e objektit

Zbatimi i normave te rregullores se teknikes se sigurimit

Për të realizuar hapjen dhe shfrytëzimin e karrierës pa probleme veçanërisht në jetën dhe shëndetin e punonjësve subjekti duhet të mbajë parasysh se problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë me të rëndësishmet dhe me të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

Drejtuësi teknik i punimeve, para fillimit të punes dhe gjatë saj, do të zbatojë rregullat dhe normat e percaktuara në:

1. Rregulloren e Teknikes se Sigurimit per Minierat dhe Karrierat te Vitit 1999 te hartuar nga Instituti i Teknologjise Nxjerrëse dhe Perpunuese te Mineraleve te miratuar me urdher te Ministrisë Nr 132, date 07.04.1999, mbështetur në nenin 17 te Ligjit Minerar Shqipetar Nr 7796, date 17.02.1994, botuar në vitin 2001
2. Rregulloren e Teknikes se Sigurimit per Punet me Lende Plasëse në Miniera dhe Nafte te hartuar nga ITNP te Mineraleve dhe te botuar me muajin Mars te vitit 2002.

Regulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik te punimeve dhe subjektit privat, do të zbatohen në çdo proces pune te percaktuar në plan- organizimin e kryerjes se punimeve te hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e firmes, i cili duhet të përmbajë:

- Plan organizimi i punimeve do të hartohet para fillimit të punimeve.
- Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik i punimeve;
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do të bëjë kontrollin teknik dhe azhurnimin e sakte të punimeve minerare të çdo lloji për të cilat subjekti ka marrë leje shfrytezimi;

- Rradha e kryerjes do te percaktohet hollesisht ne planin e masave tekniko-organizative dhe do te miratohete nga pronari i firmes;
- Ne kete plan tekniko-organizativ, masat e teknikes se sigurimit do te zene vendin kryesor .
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore , ku do te trajtohen tema te vecanta per te gjitha profesionet
- Punonjesit qe do te punojne ne karriere per berjen e minave, kontrollin e shpateve te shkalleve, shesheve te ngarkimit , rrugeve te transportit dhe zjarretaret direkt ose te nenkontratar do te testohen cdo tremujor kundrejt firmes .
- Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes, pastrimit te shesheve te shkalleve, rrugeve te transportit, krefjes dhe skarifikimit te shpateve te shkalleve te punes nenshkalleve etj.
- Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve me lende plasese te rrezimit dhe kryerjes se zbulimit ne karriere, te hartuara prapakisht nga drejtuesi teknik i punimeve dhe miratuar nga drejtuesi i subjektit .
- Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve te transportit te brendshem nga shkalla ne shkalle.
- Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve me lende plasese te rrezimit, ne rastet e perdorimit te minave te shkurtera, duke parshikuar, sipas rastit, mbulimin e vendit me materiale te parashikuara ne pasaportat e hartuara prapakisht nga drejtuesi teknik i punimeve dhe miratuar nga drejtuesi i subjektit
- Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve me lende plasese, gjate kryerjes se punimeve minerare qe do te sherbejne per rrezimin e shkembit ne variantin me dhoma minash, te parashikuara ne pasaportat e hartuara prapakisht nga drejtuesi teknik i punimeve dhe miratuar nga drejtuesi i subjektit
- Do te zbatohet nje regjim i rrepte ne aplikimin e pasaportave teknike te punimeve me lende plasese te rrezimit, ne rastet e perdorimit te puseve te sondave, duke parshikuar, sipas rastit, mbulimin e vendit me materiale te parashikuara ne pasaportat e hartuara prapakisht nga drejtuesi teknik i punimeve dhe miratuar nga drejtuesi i subjektit